

**Autoriteti Kombëtar për Certifikimin
Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike**

Nr. 8952 Prot, datë 07/ 12/2023

Akademia e Forcave të Armatosura

Nr. 4644 Prot, datë 30/ 11/2023

Marrëveshje Bashkëpunimi

Ndërmjet:

Akademisë së Forcave të Armatosura
dhe

Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
mbi

Edukimi, hulumtimi dhe trajnimin e studentëve dhe stafit akademik në fushën e sigurisë
kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike i përfaqësuar nga Prof. Asoc. Dr. Igli TAFA, dhe Akademia e Forcave të Armatosura, i përfaqësuar nga Zëvendës Komandanti Kolonel Bardhyl NUREDINAJ, në zbatim të kompetencave të tyre përkatëse, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit të programit mësimor në fushën e sigurisë kibernetike.

Neni 1

Qëllimi

“Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit midis palëve, duke përcaktuar fushat e bashkëpunimit dhe angazhimin e përgjithshëm të palëve, drejt realizimit në një moment të dytë të marrëveshjeve specifike lidhur me fushat e bashkëpunimit e shkëmbimit të listuar në nenin 2 të kësaj marrëveshje”.

Neni 2

Objekti

1. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke midis palëve në fushat si vijon:
 - a. Përçimin e dijes dhe teknologjisë përmes programeve mësimore dhe hartimin e programeve lëndor, aktiviteteve kërkimore të aplikuara në fushën e sigurisë kibernetike;
 - b. Aplikim në projekte dhe zhvillimin ose organizimin e trajnimeve lokale dhe ndërkombëtare;
 - c. Organizim aktivitetesh dhe eventesh, konferencash e tryezash të përbashkëta për shkëmbim idesh, por dhe sensibilizimin publik rreth temave me interes sigurinë dhe mbrojtjen kibernetike;

- d. Organizim të seminareve, konferencave, publikimeve dhe aktivitete të ndryshme shkencore;
- e. Përdorim të ambienteve respektivisht për praktika, laboratorë, seminare, konferenca etj.;
- f. Promovim të palëve në kuadër të aktiviteteve të secilit partner.

Neni 3

Fillimi, Kohëzgjatja dhe Përfundimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet për një afat të pacaktuar dhe Palët mund ta ndërpresin atë në çdo kohë duke njofuar palën tjetër me shkrim.
3. Aktivitetet që janë në proces në momentin e përfundimit të marrëveshjes, do të përfundojnë në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshje.

Neni 4

Informacion mbi palët

1. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike (në vijim AKCESK) është një person juridik publik me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrat, i krijuar me ligjin nr.9880, datë 25.02.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik”, i ndryshuar dhe organizohet dhe funksionon sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.2.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar për certifikimin elektronik dhe sigurinë kibernetike” i ndryshuar me VKM nr. 123, datë 1.3.2023.

2. Akademia e Forcave të Armatosura (në vijim AFA) është themeluar në vitin 1958 me Vendim të Qeverisë Nr. 136, më datë 10 maj, në Tiranë, në rajonin e Rrapit të Treshit. AFA është i vetmi institucion i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, së cilës i është dhënë status i veçantë me VKM Nr. 156, datë 19.02.2020 dhe ka varësi nga Ministri përgjegjës për mbrojtjen dhe Ministri përgjegjës për arsimin.

Neni 5

Angazhimet e përbashkëta të palëve

1. Akademia e Forcave të Armatosura:
 - a. AFA angazhohet në bashkëpunim dhe pjesëmarrjen në trajnime, workshop-e, forume, konferanca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj.;
 - b. AFA angazhohet, në bashkëpunim me partnerët, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për projekte, konsulenca apo nisma të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
 - c. AFA angazhohet të mbështesë dhe të ofrojë bashkëpunim, duke vënë në dispozicion stafin e nevojshëm ndihmës;

d. Personi i kontaktit do të jetë: Z/Znj Dr. Gentia Hoxhalli

2. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike:
 - a. AKCESK angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në trajnime, Workshop - e, forume, konferanca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
 - b. AKCESK angazhohet, në bashkëpunim me partnerët, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për projekte, konsulenca apo nisma të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
 - c. AKCESK angazhohet të mbështesë dhe të ofrojë bashkëpunim, duke vënë në dispozicion stafin e nevojshëm ndihmës;
 - d. Personi i kontaktit do të jetë: Z/Znj Oltjana Beć
3. Palët bashkërisht bien dakord si vijon:
 - a. të organizojnë takime ,sipas rastit dhe nevojës.

Neni 6

Dispozita të fundit

1. Çdo mosmarrëveshje nëpërmjet Palëve në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimeve dhe/ose negociatave ndërmjet tyre.
2. Kjo marrëveshje hartohet në gjuhen shqipe dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje për secilën Palë.
3. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet me marrëveshje reciproke me shkrim të Palëve.
4. Një ndryshim i kësaj marrëveshje do të hy në fuqi në datën e përcaktuar reciprokisht nga Palët.

Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

Akademia e Forcave të Armatosura

Kolosej Borotbyl NURESINAJ

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike

Tjili Tj.